



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim C-A

Ngarkesa: 9 kredite, 90 orë mësimore në klasë, 15 leksione dhe 65 seminare
Viti akademik,: 2024-2025, Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i shkencave ” Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”
Kodi i etikës:Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore;

T’u japë studentëve njohuri të qëndrueshme teorike dhe praktike mbi llojet kryesore të interpretimit të konferencës: konsektiv, simultan dhe me fletë.Të përgatisë studentët për kontekste reale interpretimi në fusha të ndryshme profesionale (politikë, ekonomi, drejtësi, etj.).T’i aftësojë studentët të kuptojnë rolin kompleks të interpretit si ndërmjetës gjuhësor dhe kulturor në mjedise shumëgjuhëshe.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.T’i pajisë studentët me teknikat e interpretimit (mbajtja e shënimeve, analizimi logjik, riformulimi i mesazheve, parashikimi dhe strukturimi).\
- 2.T’u ofrojë studentëve mundësinë të praktikojnë përmes simulimeve në laborator, duke analizuar performancën e tyre dhe të kolegëve.
- 3.T’i ndërgjegjësojë studentët për rëndësinë e etikës profesionale në interpretim, përfshirë sjelljen, konfidencialitetin dhe rolin neutral.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Studentët do të jenë në gjendje të interpretojnë me saktësi dhe rrjedhshmëri në situata konferenciale, duke përdorur teknikat e përshtatshme për llojin e interpretimit.
- 2.Do të jenë të aftë të analizojnë dhe strukturojnë në mënyrë logjike mesazhet, të mbajnë shënime efikase dhe të përshtaten me ritmin dhe stilin e folësit.
- 3.Do të demonstrojnë vetëdije për etikën e interpretimit dhe do të jenë të përgatitur të përballen me sfidat profesionale në mjedise shumëgjuhëshe dhe ndërkulturore.